



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

KËSHILLI

Nr. 4399 Prot.

Pogradec, më 25.10. 2023

Njoftim per konsultim publik

Keshilli i Bashkise Pogradec

Titulli: Mbledhja e rekomandimeve per prioritetet e komunitetit per Projekt Buxhetin Afatmesem 2024 – 2026 dhe per Paketën Fiskale 2024.

Propozuesi: Projekt aktet jane propozuar nga Ekzekutivi/Kryetari i Bashkise, Z. Ilir Xhakolli

Sqarime per projekt aktin: *Nevojat e komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike bazuar në buxhetin '24-'26*

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do të realizohet në datat si me poshte:

- DT 01.11.2023 ORA 10:00 Njësia Administrative Dardhas
- DT 01.11.2023 ORA 12:00 Nësia Administrative Çërravë
- DT 02.11.2023 ORA 10:00 Njësia Administrative Bucimas
- Dt 02.11.2023 ORA 12:00 Njësia Administrative Hudënisht
- Dt 03.11.2023 ORA 10:00 Njësia Administrative Trebinjë
- Dt 06.11.2023 ORA 10:00 Njesia Administrative Proptisht
- Dt 06.11.2023 ORA 13:00 Njësia Administrtive Velcan
- Dt 07.11.2023 ORA 10:00 Pogradec, salla e Këshillit Bashkiak

Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në linkun e mëposhtëm:

<https://bashkiapogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/vendimi-nr-61-1-dt-27-06-2023-2-.pdf>

Draft PBA 2024-2026

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë dhe e Këshillit Bashkiak:** Keyetari i Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të Këshillit të Bashkisë, Kryetarja e Aleancës së Grave Këshilltare, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Zyra e Financës së bashkisë, Këshilltarët e Këshillit Bashkiak Pogradec, përfaqësues nga drejtoritë e Bashkisë Pogradec.
- **Nga komuniteti:** Banorët e qytetit të Pogradecit, banorë dhe përfaqësues nga NJA, kryepleq të fshatrave, përfaqësues nga institucionet, përfaqësues nga biznesi, përfaqësues nga grupe të marginalizuara, OJF, etj
- **Forma e konsultimit:** Takim publik

Qëllimi i këshillimit publik	1. Evidentimi i nevojave të komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike bazuar në buxhetin e 22-24
Përshkrimi i çështjeve që trajton projekt buxheti afatmesëm	Miratimi i projekt buxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve për mënyrën se si janë përdorur fondet gjatë vitit 2023, nivelin e arritjes së objektivave të shërbimeve, si dhe listën me shërbime

	/ funksioneve nga e cila komuniteti përzgjedh ato shërbime për të cilat mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë tre viteve të ardhshme.
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	<p>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë? 2. Cilat janë nevojat tuaja për të cilat duhen përmirësuar shërbimet nga ana e Bashkisë? 3. Cilat janë shërbimet prioritare për të cilat bashkia duhet të shpenzojë më shumë fonde publike gjatë periudhës 2024 – 2026? 4. Për cilin shërbim publik jeni më të kënaqur? 5. Tjetër
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerret Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor; 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të

	<p>rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;</p> <p>7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;</p> <p>8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar;</p> <p>9. Monitorimi i zbatimit të tij.</p>
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	<p>Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit tone :</p> <p>Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.</p>
Kontaktet dhe afatet e degimit te komenteve, rekomandimeve, verejtjeve	<p>Sygjerimet janë të mirëpritura deri më datë 25 Nëntor 2023, në adresën e emaileve: jona.bojko@hotmail.com</p>
Data e publikimit	25.10.2023

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO

